

**KËRKESË**  
**Nr. 819/9, datë 17.7.2024**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës – Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 192,663,160.28 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e tetë) lekësh.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Hekurudha Shqiptare.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

a) Vlerësimi i pasurive të llojit “arë”, “truall”, “kulturat bujqësore” dhe investime, janë llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar; në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 29/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudha Shqiptare–Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit”, i ndryshuar; në ligjin nr. 52/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga fondi i përbashkët evropian i Ballkanit Perëndimor”, në bazë të të cilave është hartuar raporti i vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si më poshtë vijon.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Hekurudhës Shqiptare, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 192,663,160.28 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e tetë) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMIT**  
**Kastriot Gurra**

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 19, DATË 17.1.2024, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE DURRËS–TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË DHE LIDHJA ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)’”

[illegible]

[illegible]